



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Nëntor, 2021
Përmes	Muhamet Pervetica, u.d. i udhëheqësit të Sektorit të shëndetësisë - DSH
Raportuesi	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi, DSH

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes, ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit nëntor 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 42 lëndë, prej të cilave 36 lëndë ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, ndërsa 6 prej tyre i përkasin kategorive të ndryshme.

Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;

- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimit 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër; Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Informata shtesë u kërkua për aktivitetin - deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike, si dhe rrjetit të kanalizimit në komunën e Prishtinës;
- Caktohet ekipi menaxhues - furnizimi me auto-vetura për shërbime shëndetësore - ritender;
- Caktohet ekipi vlerësues dhe menaxhues - sigurimi fizik i objekteve shëndetësore - KPSH;

Pjesëmarrje në:

- Punëtorinë “Zbatimi në praktikë i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë – OSBE;
- Takim me mekanizmin koordinues kundër dhunës në familje në Komunën e Prishtinës;
- Pranohet projekti ideor “Renovimi i QMF-së 4”;
- Më 25.11.2021, për shkak të grevës së punëtorëve dhe shërbimeve shëndetësore organizuar nga FSSHK-ja, monitorohet mbarëvajtja e saj në QMF 1; QMF 2; QMF 4; QMF 3; QMF 6; QMF Mat; QMF në Matiçan dhe QMF në Velani;
- Përpilohet draft plan prokurimi i DSH-së 2022;
- Gjatë periudhës raportuese situata me pandeminë, ku ishin 28 raste aktive; shëruar 50357 raste, përderisa vdekje ishin 435 raste;
- 23 qytetarë pajisen me vërtetime mbi COVID-19.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Përgatitja e specifikave bazuar në planin e prokurimit 2021;
- Përgatitje rreth përpilimit të planit të prokurimit 2022;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;

- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore;
- Përgatitje teknike dhe administrative mbi fillimin e muajit për ekzaminime radiologjike – mamografi.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

6. Raport për muajin nëntor

Fondi burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. lëndëve
Pagat	7,570,000	6,326,555.29	563,684.12	
Mallra dhe shërbime	7,570,000			
10	1,294,300.00	1,294,300.00	65,991.02	55
21	400,000.00	400,000.00		
4	771,740.00	771,740.00	15,141.00	6
Komunali				
	300,000.00	300,000.00	19,731.97	9
Subvencione				
	150,000.00	150,000.00		
Kapitale	2,811,377.00			
21	1,600,000.00	1,600,000.00	108,250.00	3
22	1,211,377.49	1,211,377.49	109,499.12	2
Gjithësej				

Aktivitet gjatë muajit nëntor

Raport - deklarinim të borxheve më të vjetra se 30 ditë;

Deklarimi për ATK-në dhe kontrata me shërbime të veçanta;
Raporti mujor shpenzimet e realizuara dhe të hyrat nga bashkë pagesat për shërbime shëndetësore;
Pranimi i faturave dhe arkivimi i tyre;
Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në prokurim dhe financa;
Përgatitja e deklaratave të disponushemërisë për procedura të prokurimit;
Mbajtja e komisionit, më 08.11.2021, për shqyrtimin e kërkesave -trajtim mjekësor (subvencione);
Mjetet janë siguruar nga Drejtoria e Financave, në vlerë prej 51.900.00 €, gjithësej 253 persona.

6.1.1. Takimet me palë

- Çdo ditë, nga ora 9:00 deri në orën 15:00, DSH bën pranimin e palëve.

6.1.2. Takimet me institucionet e tjera

- Drejtoria e Prokurimit:
 - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;

6.1.3. Diskutime publike, takimet me qytetarë;

6.1.4. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

6.1.5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Në Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës gjatë muajit nëntor (01.11.2021-30.11.2021), janë pranuar gjithsej 42 lëndë, prej tyre 36 i përkasin trajtimeve mjekësore, ndërsa 6 prej këtyre kërkesave i përkasin kategorivë të ndryshme.

5.1.7 Përfitues të subvencioneve

Mbajtja e komisionit, më 08.11.2021, për shqyrtimin e kërkesave - trajtim mjekësor (subvencione);
Mjetet janë siguruar nga Drejtoria e Financave, në vlerë prej 51.900.00 €, gjithësej 253 persona.

5.1.8. Takime të tjera

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH,
- Numri i pamjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet i pamjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit nëntor 2021, ofroi shërbime urgjente mjekësore me ekipet urgjente dhe autoambulanca në terren për qytetarët e Prishtinës dhe fshatrave të komunës.

Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor përmes përgjegjësve të turneve, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës së urgjencës, rastet me frekuencë më të lartë:

- Hipertension arterial;
- Sëmundjet kronike pulmonare;
- Gjendjet gripoze me temperaturë të lartë;
- Colikat abdominale;
- Sindromi akut koronar;
- Infarkti akut i miokardit;
- Ataquet cerebrovasculare;
- Pneumonitë atipike, post Covid-19;
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut;
- Lëndimet etj.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Në kuadër të EVP-së, në sallën e trajnimit dhe edukimit të QMU-së, më 26.11.2021, nga ora 9:00 deri në orën 9:45, është mbajtur ligjerata “Vlerësimi dhe menaxhimi i pacientit në kushte terreni”, ndërsa prej orës 10:00 deri në orën 15:00 në të njëjtën ditë është mbajtur trajnimi: “Mbështetja themelore e jetës” (MTHJ), AED; BLS-D, mbështetja e avansuar e jetës (MAJ), ALS;

Më 12-13 nëntorë, si institucion mori pjesë në Kongresin e 5-të, internacional për trauma dhe kirurgji emergjente mbajtur në Tiranë;

U prezentua në Sesionin e tretë në kuadër të emergjencave paraspitalore me temën: “PANDEMIA COVID-19”;

Të njohurat të panjohurat dhe sfidat e Qendrës së Mjekësisë Urgjente gjatë periudhës mars-dhjetor 2021.

Situata me pandeminë COVID-19

Ekipet mjekësore përgjigjen në thirrje, duke iu ofruar ndihmë në shtëpi dhe transport me ekip mjekësor dhe autoambulancë deri në klinikat e QKU-së ku trajtohen rastet me COVID 19;

Është vazhduar edhe gjatë muajit nëntor, në 7 ditë të javës prej orës 07:00 deri në orën 20:00, një ekip mjekësor nga QMU-ja, duke kujdestaruar në sallën 1 tetori për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat të cilët kishin nevojë për tretman dhe këshilla mjekësore gjatë vaksinimit;

Konform kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë - Komitetit për imunizim të popullatës me vaksinën kundër COVID-19, nga data 04.11.2021, prej orës 12:00 deri në orën 20:00, çdo ditë (24/7) gjatë muajit nëntor, një ekip mjekësor nga QMU-ja asistoi ekipet e vaksinimit nga QKMF-ja, në qendrën tregtare “Albi Mall” në Veternik;

Përderisa vaksinimi filloi edhe në shkolla të mesme, atëherë ekipi mjekësor nga QMU-ja ndihmon edhe këtë aktivitet.

Mbështetja e manifestimeve sportive

Ekipet mjekësore të QMU-së me autoambulanca mbështetën ndeshjet futbollistike dhe stervitjet, sipas kërkesës së Federatës futbollistike të Kosovës, sipas këtyre termineve:

06.11.21	15:00 - 17:00	Stadiumi në Hajvali	2-orë	Jordani
07.11.21	15:00 - 17:00	Stadiumi në Hajvali	2-orë	Jordani
08.11.21	16:00 - 18:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	2-orë	Jordani
	18:00 - 19:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	1-orë	Kosova
09.11.21	12:00 - 13:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	1- orë	Jordani
	18:00 - 19:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	1- orë	Kosova
10.11.21	17:00 - 21;00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	4- orë	Kos vs Jord
11.11.21	12:00 - 14:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	2-orë	Jordani
11.11.21	17:00 - 18:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	1-orë	Kosova
12.11.21	12:00 - 14:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	2-orë	Jordani
12.11.21	18:00 - 19:00	Stadiumi “Fadil Vokrri”	1-orë	Kosova

Kombtarja U18

09.11.21	12:00 - 13:00	Stadioni në Hajvali	1-orë	Turqia
09.11.21	14:00 - 15:00	Stadioni në Hajvali	1-orë	Kosova
10.11.21	13:00 - 17:00	Stadioni në Hajvali	4-orë	Kos vs Tur
11.11.21	12:00 - 13:00	Stadioni në Hajvali	1-orë	Turqia
11.11.21	14:00 - 15:00	Stadioni në Hajvali	1-orë	Kosova
12.11.21	13:00 - 17:00	Stadioni në Hajvali	4-orë	Kos vs Tur

Më 15.11.2021, asistencë në stërvitje, nga ora 17:00 deri në orën 20:00, asistencë me auto ambulancë për stërvitjet zyrtare;

Po ashtu ditën e ndeshjes, më 16.11.2021, nga ora 18:00 deri në orën 22:00 një autoambulancë me ekip mjekësor ka asistuar në ndeshje zyrtare të FFK-së; Stërvitja dhe ndeshja është zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”;

Më 23, 24 dhe 25.11.2021 nga orën 10:00 deri në orën 13:00, ekipi mjekësor me autoambulancë ka asistuar në turnirin dhe ndeshjeve për kategorit e reja të Federates së futbollit të Kosovës të cilat janë mbajtur në kampusin stervitor në fshatin Hajvali.

RAPORTI I SHËRBIMEVE PËR MUAJIN NËNTOR I KORDINATORËS SË SISH - it, në QMU

1	Viz.mj. urgj. në terren	1241
	Viz. mj. tjera	5
2	Vizita mjeksore në QMU	3
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
4	Shërbimi i rea. në terren	1
	Shërbimi i rea. në QMU	0
5	Observim (intenziv)	3
6	Shërbimi i infermierisë	0
7	Aksidentet	130
8	Fatekeqësitë në punë	0
	Fatekeqësitë të tjera	58
9	Shërbimi laboratorik	0
10	EKG	19
11	Transportet	337
12	Konstatim vdekjeje	52
	GJITHSEJ	1849

ZYRA E PROKURIMIT NË QMU

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese;
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në Komunë dhe bashkëpunimi sipas UA, 2016 të LPP me AQP për kyçje në kontratat e centralizuara,
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorinë e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranim të mallrave, shërbimeve, caktimin e menaxherëve të kontratave etj., sipas nevojave të paraqitura.

❖ **AKTIVITETET E ZBATUARA**

- Nxjerrja e urdhërblereve në sistemin “FREE BALANC” për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzojnë QMU-ja;
- Vlerësimi i ofertave për furnizim me material administrativ shëndetësor në QMU;
- Njoftimi për dhënie kontrate, nënshkrimi i kontratës;
- Caktimi i komisionit për pranim të mallit dhe pranimi i raportit nga komisioni, fatura, fletë dërgesa, konstatimit dhe përgatitja e lëndës për pagesë;
- Pranimi i kërkesës dhe dokumentet tjera përcjellës për fillimin e procedurës për furnizim me material shpenzues shëndetësor në QMU;
- Punimi i DT në platformën e E-prokurimit;
- Njoftimi për kontratë;
- Pranimi i kërkesës dhe dokumentet tjera përcjellës për fillimin e procedurës për furnizim me shtretër (kauqa) në QMU;
- Punimi i DT në platformën e E-prokurimit;
- Njoftimi për kontratë;
- Vlerësimi në procedurë.

❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës;
- Hapja e ofertave për furnizim me material shpenzues shëndetësor në QMU;
- Vlerësimi i ofertave dhe vazhdimi i procedurës tutje;
- Vazhdimi i procedurës dhe vlerësimi i ofertave për procedurat në fjalë.

ZYRA E FINANCAVE NË QMU

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës në lidhje me furnizimet e nevojshme për fund të vitit për shkak të afateve kohore të caktuara nga Ministria e Financave.
- **AKTIVITETE TE PËRFUNDUARA**
- Përgatitja e lëndëve të poshtëshënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre,
- Shpenzimet e telefonit për muajin tetor,
- Shpenzimet e tel. në rr. “Xhemajl Ibishi” për muajin tetor,
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin tetor,
- Furnizim me ujë për pije për muajin tetor,
- Shfrytëzimi i automjetit me qira për muajin tetor,
- Furnizim me karburante për muajin tetor,
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj. për muajin nëntor,
- Përgatitja e pagave për 3 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin tetor,
- Përgatitja e formularëve me dokumente përcjellëse për punëtorët e ri,
- Zotimi i mjeteve për faturat që vijnë në muajin në vijim.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPER**

- Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë,
- Fatura e rrymës,
- Sigurimi i autoambulancave,
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira dhe printerëve,
- Mbushje telefonike për punëtorë,
- Përgatitja e ndërrimeve të natës,
- Përgatitja e faturave komunal (rrymë, ngrohje, PTK), të cilat janë të rregullta së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera,
- Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e parasë së imët.

Faturat e lartcekura janë të rregullta çdo muaj dhe duhet të përgatiten me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe të dërgohen në DSH.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
 - Tri qendra të mjekësisë familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerë (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 deri në orën 13:30; 13:30 deri në orën 20:00 dhe 19:00 deri në orën 07:00);
 - Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare punojnë me orar të rregulltë (07:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 20:00);

- Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare, kujdestaria e rregullt mujore e shtunë (07:00 deri në orën 19:00) dhe e diel (07:00 deri në orën 13:00);
- Në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës janë punuar 996 teste, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit ku janë punuar 486 D-dimera, që të dyja këto falas, po ashtu janë punuar edhe testet serologjike 30 teste;
- Numri i konsultave virtuale gjatë muajit nëntor ka arritur në 163 konsulta;
- Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik, orari i punës (07:00deri në orën 15:00), shërbimi stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;
- Shërbimi pediatrik, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 dhe 13:30 deri në orën 20:00);
- QMG, orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- Shërbimi specialistik orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- Mjekësia e punës, orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- DAT, orari i punës (07:00 deri në orën 13:00);
- Laboratori qendror orari i punës (07:00 deri në orën 14:00 dhe 13:00 deri në orën 20:00);
- Radiologjia orari i punës (07:00 deri në orën 13:00), në funksion për momentin janë dy njësi radiologjike në QKMF dhe në QMF 5;
- Shërbimi i vaksinimit orari i punës (08:00 deri në orën 16:00), orari është përshtatur për arsye se pjesa më e madhe e punëtorëve shëndetësorë nga data 29.03.2021 janë duke kontribuar në sallën "1 Tetori" rreth vaksinimit të qytetarëve kundër COVID -19, ku deri tani janë administruar 248, 354 doza dhe me vaksinë kundër gripit 7,908 doza, kemi 8 ekipe të përbëra nga mjekë dhe infermierë, gjithsej 26 punëtorë nga QKMF-ja dhe ekipet mbështetëse nga MSH;
- AMF të (punon çdo ditë pune nga ora 07:00 deri në orën 14:00 mjeku dhe infermieri në Shkabaj, Mramor, Bardhosh dhe LLukar;
- AMF në Barilevë nga data 22.11.2021 filloi punën, me orar 07:00 deri në orën 14:00;
- Në Keqekollë punon tri ditë në javë (e hënë, e mërkure dhe e premte);
- Në Koliq (të martën mjeku ndërsa infermieri çdo ditë);
- Në Dabishevc (e enjte ekipi komplet);
- Në Viti dhe Bullaj nuk punon për momentin;
- Në Slivovë (e martë dhe e enjte mjeku punon ndërsa infermieri çdo ditë;
- Në Sharban, Rimanishtë dhe Kishnicë (infermieri çdo ditë dhe higjienisti);
- Numri i stafit të infektuar gjatë muajit nëntor ishte një punëtor shëndetësor i infektuar. Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk u konstatua ndonjë mangësi serioze;
- Respektohen rregullat e përgjithëshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Viz. mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
83266	73788	93220	11981	2469	264724

NGA: Poliklinika Stomatologjike

Numri i pacienteve në Shërbimin Stomatologjik të QKMF-së në Prishtinë:

4718 , numri me participim 689, të hyra 1516.50 euro;

Shërbimi i rëntgenit në poliklinikën stomatologjike në QKMF;

Numri i grafive: 462 - numri me participim: 156;

Të hyra: 247.50 euro;

8 punëtorë në pushim mjekësor, 4 punëtorë në pushim të lindje, 3 punëtorë me orar të shkurtuar për gjidhënie, 2 punëtorë të liruar (shtatzëna), një vizite në QMF 1, nje vizitë në QMF 2, një vizitë në QMF 3, një vizitë në QMF 6, një vizitë në QMF 7, një vizitë në QMF 8, një vizitë në QMF 9, një vizitë në QMF 10;

Dy vizita në QMF në Hajvali, një vizitë në QMF në Besi, një vizitë në QMF në Mat dhe një vizitë në QMF, Mëhalla e Muhaxhirëve;

Një takim me kryeshefin e QKMF-së dhe një vizitë në QMF 4 me drejtorin dhe përfaqësues të DSH-së për inventarizimin e kësaj qendre.